



## Ministrja Milva Ekonomi nderohet me çmim nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë



Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë si çdo vit, në një mbrëmje gala ka ndarë çmimet e përvitshme për personalitete të shtetit shqiptar, drejtues institucionesh, kompani dhe ndërmarrje të rëndësishme. Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi është nderuar me një çmim të posaçëm nga kjo Dhomë dedikuar personaliteteve të vendit, me motivacionin: "Znj. Milva Ekonomi, anëtarja e qeverisë që ka krijuar standardin e duhur në dialogun publik-privat. Qasja e sipërmarrjes private në tryezat e punës si dhe ngritja e problemeve për zgjidhje janë kontributi dhe besimi që na ka dhënë i zonjës Ekonomi, nën cilësinë e Ministres së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes".

## Korça me projekte të reja turistike



Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA), Ambasada e Zvicrës nëpërmjet Projektit RisiAlbania dhe Industria Shqiptare e Turizmit organizuan eventin e radhës, ku shpallën dhe 4 projektet fituese të konkursit “Risi Turistike Korçë 2017”. Në konkurs u prezantuan gjithsej 10 projekte, të cilat përfshinin ide për eksplorimin e qytetit të Korçës dhe Pogradecit, ide për kulinarinë, artizanatin, etj. Projektet fituese: “Treni panoramik për turin e qytetit – një risi turistike për Rajonin e Korçës”, “Transhumanca”, “Eksplorojmë Pogradecin me biçikleta”, “Krijimi i Suvenireve Unike për Korçën” do të financohen nga Risi Albania dhe AIDA, përmes fondeve për artizanatin dhe kompanitë start-up. Drejtori i AIDA, z. Genti Beqiri u shpreh se qyteti i Korçës është një ndër qarqet kryesore me të cilat ka bashkëpunuar AIDA, pasi ky qytet ofron një turizëm të qëndrueshëm në 365 ditët e vitit, si në verë dhe në dimër, ndaj është një model që duhet ndjekur. Z. Beqiri tha se AIDA do të vazhdojë të mbështesë vazhdimin e konkursit Risi Turistike dhe në rajone të tjera të vendit

### Forumi i Akademisë së Shkencave, diskutohet perspektiva e zhvillimit ekonomik



Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Turqi me temë: “Modelet e investimeve jashtë buxhetore: Partneriteti Publik Privat”. Ky aktivitet përkoi me dy vjetorin e krijimit të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Turqi. I pranishëm ishte dhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Genti Sejko. Ministrja Ekonomi tha në fjalën e saj se tashmë rritja ekonomike e Shqipërisë është e qëndrueshme dhe bashkëpunimi mes qeverisë dhe biznesit ka hyrë në një fazë të re, ku edhe ndryshimet që bëhen në legjislacionin fiskal vijnë si rezultat i komunikimit të shtuar mes biznesit dhe qeverisë. Në Shqipëri, tha ministrja, ka shumë mundësi në përmirësimin e shërbimeve publike, si në arsim, shëndetësi, infrastrukturë, por edhe në sektorin e turizmit, si një sektor nxitës i zhvillimit ekonomik të vendit. Ministrja tha se ndryshimet në ligjin për partneritetin publik privat zgjeruan hapësirën ku mund të zbatohen projektet PPP dhe më e rëndësishme, shumica për projektet PPP nuk duhet tejkalojë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës buxhetor. Ministrja bëri me dije se në muajin janar të vitit 2017 qeveria do të lançojë projektin “One Billion Project Financing”, i cili është i orientuar kryesisht drejt infrastrukturës, shëndetësisë, edukimit dhe turizmit, ku partnerët kryesorë në realizimin e këtij projekti do të jenë padyshim bankat, kur projektet që do të financohen duhet të jenë serioze dhe të mbartin me vete sa më pak risk në momentin që ato zbatohen

## MZHETTS trajnim për rritjen e ndërgjegjësimit në fushën e ndihmës shtetërore



Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) nëpërmjet Sektorit të Kontrollit të Ndihmës Shtetërore, si dhe me mbështetjen e projektit të financuar nga IPA 2014, organizoi me nëpunës të Bashkisë së Durrësit trajnimin me temë “Kuptimi dhe parimet kryesore të kontrollit të ndihmës shtetërore”. Trajnimi kishte për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit në fushën e ndihmës shtetërore. Gjatë trajnimit përveç prezantimit të qëllimit të punës së sektorit të ndihmës shtetërore në vend, u shpjegua funksioni dhe organet kontrolluese të ndihmës shtetërore. Z. Sigitas Cemnolonksi, eksperti i kontraktuar, shpjegoi konceptin dhe parimet themelore të ndihmës shtetërore. Pjesëmarrësit diskutuan dhe ngritën pyetje në lidhje me përjashtimin nga taksat të ndërmarrjeve në qytetin e Durrësit, rastet e ndihmës shtetërore për të eliminuar efektet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose situata të jashtëzakonshme, ndihmën de-minimis dhe ndihmën për sektorin e pyjeve.

## Prezantohen guidat turistike për 15 qendra banimi në Himarë



“Në zbulim të mistereve të jugut” është projekti më i ri që synon prezantimin e bukurive natyrore, historike, kulturore dhe vlerat e traditës mikpritëse dhe të kulinarisë të jugut të Shqipërisë. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në bashkëpunimin me kooperacionin gjerman “GIZ” prezantuan guidat turistike për 15 qendra banimi në Bashkinë e Himarës. Ekspozimi i prodhimeve artizanale, piktura të peizazheve të zonës, degustimi i kuzhinës tradicionale dhe prodhimeve ushqimore si dhe larmia e grupeve folkloristike i dhanë bukuri këtij aktiviteti. Një tjetër surprizë e bukur ishte dhe vizita në fshatin Pilur të Himarës, ku përveç mikpritjes në njërën prej bujtinave tradicionale siç është “Vila Çipa”, të pranishmit shijuan dhe performancën e grupit të valleve të Tropojës, të ardhur posaçërisht për këtë aktivitet. Aktiviteti shërbeu gjithashtu dhe si shkëmbim i përvojave dhe takimeve të grupeve të ndryshme të interesit në fushën e turizmit.



## DPPM seminar për rëndësinë e pronësisë intelektuale



Drejtorja e Përgjithshme e Patentave dhe Markave në bashkëpunim ndërinstitucional ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, ZSHDA dhe Universitetin POLIS zhvilluan seminarin me teme “Promovimi i EEN-AL, programet financuese të BE për NVM, Patentat, Markat dhe e drejta e autorit”. Ky seminar i vjen në ndihmë nxitjes së inovacionit dhe promovimit të mbrojtjes dhe rëndësisë së pronësisë intelektuale. Aktiviteti u zhvillua në vazhden e sesioneve informuese që DPPM në bashkëpunim me ZSHDA kanë marrë përsipër të realizojnë me sistemin universitar, me qëllim edukimin dhe rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit tek brezat që edukohen.

## DPA trajnim mbi vlerësimin e cilësisë dhe sistemet e menaxhimit të mjedisit në organizmat certifikues



Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit në bashkëpunim me Projektin TAIEX, organizuan në Tiranë në datat 21 – 22 Dhjetor 2016, trajnimin me titull “Mbi Vlerësimin e Cilësisë dhe Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit në Organizmat Certifikues”. Qëllimi i trajnimit ishte dhënia e një pasqyre të përgjithshme të ndryshimeve të disa standardeve ISO, që lidhen me certifikimin e sistemeve të menaxhimit. Seminari u fokusua në standardin ISO / IEC 17021-1: 2015 duke paraqitur parimet dhe kërkesat për kompetenca, dhe paanshmërinë e organeve që ofrojnë auditimet dhe certifikimet e të gjitha llojeve të sistemeve të menaxhimit. Trajnimi kishte për qëllim rritjen e kapacitetit të stafit dhe vlerësuesve teknik të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit për të kryer vlerësimin e trupave certifikues sipas këtyre standardeve të reja

## Hapa konkretë drejt reformës së sistemit të Pronësisë Industriale në Shqipëri

Këshilli i Ministrave në mbledhjen e datës 21/12/2016, miratoi projektligjin PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9947, datë 07.07.2008, "PËR PRONËSINË INDUSTRIALE", Të ndryshuar. Ky projektligj u hartua nga Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave me mbështetjen e Ministrisë së Ekonomisë Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes duke u bazuar edhe në konsultimin dhe bashkëpunimin e ngushtë me ekspertët e organizatave ndërkombëtare më të fuqishme në botë mbi pronësinë intelektuale si: Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale; Zyra Evropiane e Patentave dhe Zyra e Bashkimit Evropian për Pronësinë Intelektuale. Bazuar në këtë ligj, do të mundësohet lehtësimi i procedurës së aplikimit për regjistrimin e Patentave mbi Shpikjet, Modeleve të Përdorimit, Markave Tregtare, Disenjove Industriale dhe Treguesve Gjeografikë. Afatet e regjistrimit do të shkurtohen ndjeshëm dhe do të rritet cilësia e ekzaminimit të objekteve të Pronësisë Industriale.

### Numër i lartë aplikimesh kombëtare për mbrojtjen e Markave Tregtare

	Aplikime për patenta kombëtare
2010	2
2011	5
2012	5
2013	4
2014	12
2015	17
2016	25
Total	45

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave, institucion në varësi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, shënon numrin më të madh ndër vite të aplikimeve për regjistrim të Markave Tregtare dhe të Shërbimit. Këtë fundvit janë regjistruar mbi 1000 aplikime, ndërkohë që numri i tyre rritet çdo ditë. Kjo shifër është tregues i rritjes së nivelit të ndërgjegjesimit të biznesit për përfitimet e mbrojtjes së pronës industriale. Mbrojtja e markave në territorin shqiptar ka efekt të drejtpërdrejtë në sigurimin e konkurrencës së ndershme dhe krijimin e një tregu të besueshëm dhe atraktiv edhe për kompanitë e huaja. Rritje të ndjeshme të aplikimeve ka edhe për Patentat për shpikjet nga shtetas shqiptarë. Për të bërë krahasimin shihni tabelat bashkëngjitur që tregojnë aplikimet që nga viti 2010 për patenta dhe për marka.

### ‘Nove Colonne’ për Shqipërinë: Ka gjithçka për të ofruar, natyrë, kulturë, traditë dhe aventurë



Mediat italiane vazhdojnë t'i bëjnë jehone Shqipërisë turistike, duke ftuar të gjithë ata italiane që nuk e kanë vizituar këtë vend, ta konsiderojnë si destinacionin e radhës. Agjencia Kombëtare e Lajmeve ‘Nove Colonne’, shkruan se Shqipëria ka gjithçka për të ofruar: natyrë, kulturë, traditë, aventurë. Ndërsa lagenziadiviaggi.it e paraqet Shqipërinë si parajsën që nuk e pret. “Pesë mijë vjet histori, 22 parqe, muze, vende arkeologjike, përfshirë në UNESCO-s dhe një vijë bregdetare mbi 300 kilometra të gjatë. Janë numrat e Shqipërisë, vendit të shqiptonjave, që sot në Itali u promovua me slogani që përmbledh thelbin: Parajsa surprizë”, shkruan lagenziadiviaggi.it. ‘Shqipëria nuk është më një vend i stereotipeve të vjetra, por një destinacion mesdhetar me një mikpritje unike dhe natyrë të magjishme për t’u zbuluar’, thuhet në shkrimin e publikuar në ‘Nove Colonne’. Turizmi në Shqipëri, vijohet më tej, është një surprizë vetëm për ata që kurrë nuk kanë pasur fatin e mirë për të vizituar vendin.

## DPS- Standarde

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) ka publikuar standardin SSH EN 16718:2015 “Dru dhe produktet me bazë druri – Doza e karbonit organik total (TOC) në dru dhe në produktet me bazë druri”.

### Qëllimi i standardit

Ky standard përkrah metodën për përcaktimin e karbonit organik total me anë të diferencës ndërmjet rezultateve të matjeve të karbonit total (TC) dhe karbonit inorganik total (TIC). Kjo metodë zbatohet në të gjithë tipet e drurit, materialet me bazë druri (panelet, kompesatat, etj.) si dhe në drurët që përmbajnë përbërës kimik në përgjithësi.

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) ka publikuar standardin SSH EN 13406:2002 “Makinat bujqësore - Çisternat për lëngjet dhe pajisjet shpërndarëse - Mbrojtja e mjedisit - Kërkesat dhe metodat e provave për saktësinë e shpërndarjes”.

### Qëllimi i standardit

Ky standard përcakton kërkesat për ruajtjen e mjedisit dhe verifikimin e tij për projektimin dhe ndërtimin e çisternave të lëngjeve për transmetimin (përcjelljen) dhe shpërndarjen e lëngjeve në bujqësi dhe hortikulturë. Ky standard përcakton kërkesat tërthore, karakteristikat gjatësore dhe karakteristikat e gjerësisë të shpërhapjes në kushte të pranueshme pune dhe rrjedhjes së qëndrueshme brenda zonës së lejuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) ka publikuar standardin SSH EN 13080:2002 “Makinat bujqësore - Shpërndarëset e plehut - Mbrojtja e mjedisit - Kërkesat dhe metodat e provës”.

### Qëllimi i standardit

Ky standard përcakton kërkesat për ruajtjen e mjedisit dhe verifikimin e tij për projektimin dhe ndërtimin e shpërndarësve të plehut organik për shpërhapjen e plehut në bujqësi dhe hortikulturë. Ky standard përcakton kërkesat tërthore, karakteristikat gjatësore dhe karakteristikat e gjerësisë të shpërhapjes së plehut organik në kushte të pranueshme pune, rrjedhjes së qëndrueshme brenda zonës së tolerancës dhe koeficientit të variacionit për shpërhapjen gjatësore.

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) ka publikuar standardin SSH EN 13206:2002 “Fletë termoplastike mbuluese për përdorim në bujqësi dhe hortikulturë (perimtari)”.

### Qëllimi i standardit

Ky standard ka për qëllim të vendosë kërkesat bazë për karakteristikat fizike dhe mekanike të llojeve të ndryshme të fletëve termoplastike mbuluese për përdorim në bujqësi dhe hortikulturë.

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) ka publikuar standardin SSSH EN 13031-1:2002 “Serrat - Projektimi dhe ndërtimi - Pjesa 1: Serrat për prodhim tregtar”.

### Qëllimi i standardit

Ky standard specifikon parimet dhe kërkesat për qëndrueshmërinë dhe stabilitetin mekanik, aftësinë e shërbimit dhe kohëzgjatjen për projektimin dhe ndërtimin e prodhimeve tregtare strukturat e serrës pavarësisht nga lloji i materialit, duke përfshirë themelet e tyre, për prodhimin profesional të bimëve dhe të prodhimeve të tjera.



Adresa: Blvd. “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Albania

Tel. / Fax: +355 42 22 34 55 / +355 42 22 34 55

E-mail: [zmp@ekonomia.gov.al](mailto:zmp@ekonomia.gov.al)

Web: [www.ekonomia.gov.al](http://www.ekonomia.gov.al)

